



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality

- Kuvendi Komunal

01 Nr.06-47/1

Dt.25.05.2010

D r a g a s h

Kuvendi Komunal i Dragashit, në seancën e dt.25.05.2010, pas rishqyrtimit të çështjes së rikthimit të pasurisë shoqërore KK-së Dragash, miraton këtë :

V E N D I M

- I. **VERIFIKOHET** Vendimi i mëparshëm i Kuvendit Komunal të Dragashit 01 Nr.06-137/1 i dt.27.09.2009 lidhure me shfuqizimin e Aktvendimit të ish-Këshillit Popullor të Komunës së Dragashit i dt.20.05.1960 04-Nr.1536/60 i mbështetur atëherë në Ligjin e Shfrytëzimit të Kullosave (G.Zyrtare e RPS” nr.15/60) me të cilin prona shoqërore(kullotat e larta dhe të ulëta) i ndahet në shfrytëzim kooperativës bujqësore në Dragash ...
- II. Parcelat nga pika I e këtij Aktvendimi i rikthehet në pronësi pronarit të mëparshëm-Komunës së Dragashit e cila menaxhon pronën shoqërore
- III. Për implementimin e këtij Vendimi **AUTORIZOHET** Drejtorati për Urbanizëm, Gjeodezi dhe Katastër të KK-së bazuar në librat kadastral të së kaluarës, siç ka qenë më parë.
- IV. Pas rikthimit të pronës, Kuvendi Komunal i Dragashit, do të nxjerr Rregullore të posaçme për menaxhimin e kësaj pasurie shoqërore.

Arsyetim

Këshilli Popullor i Komunës së Dragashit, më 20.05.1960, sipas Ligjit për Shfrytëzimin e Kullosave (“Gazeta Zyrtare RPS nr.15/60), me kërkesën e kooperativës bujqësore në Dragash, ka miratuar Aktvendimin 04 Nr.1536/60 me të cilin e ka dhënë në shfrytëzim pronën shoqërore- komunale, sipas Listës në shtojcë të atij Aktvendimi.

Por, me rastin e inqizimit aero-fotogrametrik të vitit 1981 dhe krijimin e operarit të ri kadastral, **padrejtësisht dhe gabimisht**, është bërë regjistrimi-bartja e pronës komunale në emër të NBQ “Sharrprodhimi” me seli në Dragash.

Prandaj, meqenëse ndryshimi në pronë të regjistrave kadastral bëhen vetëm me vendime të Kuvendit Komunal dhe aktvendimet e gjykatave, është parë e domosdoshme që të miratohet Vendimi i larpërmendur dhe prona e regjistruar gabimisht i rikthehet titullarit të mëparshëm si ne dispozitiv të këtij vendimi Kuvendit të Komunës së Dragashit, gjegjësisht organeve të saj.

Shtojcë : Aktvendimi nr.04-Nr.1536/60 dhe Vendimi i KK-së Dragash 01 Nr.06-137/1

I dërgohet :

- Drejtoratit për Urbanizëm, Gjeodezi dhe Katastër të KK-së, drejtorit Shefik Fejza,
- Agjencionit Kosovar të Pronës-Prishtinë,
- NBQ “Sharrprodhimi”-Dragash, drejtorit Nijazi Tërshnjaku,
- Avokatit Publik Komunal në Dragash-Bean Haxhihasan, dhe
- Arkivit

